



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2022 – Numri: 91

Tiranë – E enjte, 16 qershor 2022

PËRMBAJTJA

	Faqe
Udhëzim i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 10, datë 1.6.2022	Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 2, datë 14.2.2013, “Për krijimin dhe funksionimin e Komitetit Shkencor dhe të paneleve shkencore pranë Autoritetit Kombëtar të Ushqimit”..... 11737
Urdhër i ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 211, datë 10.6.2022	Për delegim kompetencash..... 11737
Vendim i Komisionit të Ndhmës Shtetërore nr. 105, datë 24.5.2022	Autorizim i ndihmës shtetërore “Për mbështetjen e <i>startup</i> -eve dhe lehtësuesit e <i>startup</i> -eve”..... 11737
Vendim i Komisionit të Ndhmës Shtetërore nr. 106, datë 24.5.2022	Autorizim i ndihmës shtetërore “Për Aeroportin Ndërkombëtar të Vlorës”..... 11740
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 87/9, datë 15.6.2022	Për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, të cilat preken nga disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 354, datë 16.6.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit ‘Për projektim, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e rrugës ‘Porti i Jahteve’– Bypass Orikum–Dukat (Ura e Shën Elizës)’”..... 11743
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 288/7, datë 13.6.2022	Për shpronësim për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 144, datë 22.2.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit ‘Rikualifikimi urban i qytetit të Pukës’”..... 11748

**UDHËZIM**

Nr. 10, datë 1.6.2022

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË UDHËZIMIN NR. 2, DATË 14.2.2013,
“PËR KRIJIMIN DHE FUNKSIONIMIN
E KOMITETIT SHKENCOR DHE TË
PANELEVE SHKENCORE PRANË
AUTORITETIT KOMBËTAR
TË USHQIMIT”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, nenit 66, të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008, “Për ushqimin”, i ndryshuar, dhe të VKM-së nr. 708, datë 9.9.2020, “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit”,

UDHËZON:

Neni 1

1. Pika 6 e udhëzimit, riformulohet si më poshtë vijon:

“6. Komiteti dhe panelet shkencore përbëhen nga ekspertë me kualifikim akademik, mbajtës të titullit profesor i asociuar ose doktor shkencash, si dhe me arritje profesionale në fushat shkencore të cilat lidhen me sigurinë ushqimore. Komiteti ka në përbërje të tij 5 anëtarë, ndër të cilët 2 janë kryetarët e paneleve. Panelet kanë në përbërje të tyre 3 anëtarë”.

2. Pika 16 e udhëzimit, riformulohet si më poshtë vijon:

“16. Mbledhja e Komitetit është e vlefshme kur janë të pranishëm të paktën 3 anëtarë”.

3. Pika 21 e udhëzimit, riformulohet si më poshtë vijon:

“21. Sektori i Aktivitetit Shkencor dhe Komunikimit me RASFF.”

Neni 2

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Frida Krifca**

URDHËR

Nr. 211, datë 10.6.2022

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Mbështetur në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; në ligjin nr. 23/2015, “Për shërbimin e jashtëm të RSH-së”; në nenet 22 e vijuese, të ligjit nr. 44, datë 30.4.2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe në nenin 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, zëvendësministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, znj. Megi Fino.

2. Këto kompetenca do të ushtrohen nga data 9.6.2022 deri në datën 10.6.2022, me ndërprerje kur kompetencat do të rimerren nga titullari i institucionit.

3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet zëvendësministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, znj. Megi Fino.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME
Olta Xhaçka**

VENDIM

Nr. 105, datë 24.5.2022

**AUTORIZIM I NDIHMËS
SHTETËRORE “PËR MBËSHTETJEN E
STARTUP-eve DHE LEHTËSUESIT
E STARTUP-eve”**

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, me pjesëmarrjen e:

- Znj. Delina Ibrahimaj kryetare;
- Znj. Mimoza Dhëmbi anëtare;
- Znj. Etleva Haka anëtare;
- Znj. Mirjana Zisi anëtare;
- Z. Ahmet Maçellari anëtar,

në mbledhjen e tij të radhës të datës 24.5.2022, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në bazë të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar; të vendimit të Këshillit të



Ministrave nr. 817, datë 28.12.2005, “Për miratimin e rregullores Për procedurat dhe formën e njoftimit”, morri në shqyrtim njoftimin e ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, të planit të ndihmës shtetërore për *startup*-et dhe lehtësuesit e *startup*-eve.

I. Procedura

1. Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes me shkresën nr. 2439, datë 28.4.2022, në bazë të nenit 20, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, njoftoi në Komisionin e Ndihmës Shtetërore planin e ndihmës shtetërore të sipërpërmendur, në bazë të projektvendimit të KM-së “Për përcaktimin e kërkesave dhe kritereve që duhet të plotësojnë *startup*-et dhe lehtësuesit e *startup*-eve, si dhe miratimin e procedurave dhe afateve të thirrjes për përfitimin e granteve dhe masave mbështetëse”.

II. Përshkrimi i masës

2. *Objekti*: Plani i ndihmës ka si objekt mbështetjen me grant të *startup*-eve dhe lehtësuesve të *startup*-eve, të cilët zhvillojnë projekte inovative në fusha prioritare për zhvillimin e vendit, si:

- Mbështetja e inovacionit në fusha prioritare për zhvillimin e vendit;
- Mbështetja e iniciativave që kanë impakt pozitiv mjedisor;
- Fuqizimi i rinisë;
- Fuqizimi i vajzave dhe grave sipërmarrëse;
- Fuqizimi i përfshirjes sociale, diversiteti dhe impakti social;
- Prioritete të tjera, sipas urdhrit të ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes.

3. *Baza ligjore*: Plani i ndihmës shtetërore mbështetet në projektvendimin e KM-së “Për përcaktimin e kërkesave dhe kritereve që duhet të plotësojnë *startup*-et dhe lehtësuesit e *startup*-eve, si dhe miratimin e procedurave dhe afateve të thirrjes për përfitimin e granteve dhe masave mbështetëse”.

4. *Kobëzgjatja*: Plani i ndihmës do të zbatohet në vitin 2022.

5. *Dhënësi i ndihmës* dhe autoriteti përgjegjës për zbatimin e masës është ministri përgjegjës për sipërmarrjen.

6. *Përfituesit*: Përfitojnë mbështetje me grant:

- a) Kategoria e *startup*-ve, sipas klasifikimit të mëposhtëm:
 - *Startup*-et në fazën fillestare;
 - *Startup*-et në fazën e rritjes;

- *Startup*-et në fazën e zgjerimit.

b) Kategoria e lehtësuesit të *startup*-eve, sipas klasifikimit të mëposhtëm:

- Akademia, e cila përfshin universitetet publike dhe private;
- Lehtësuesit, si inkubatorët dhe përsheptuesit;
- Hapësirat e punës, të cilat përfshijnë ofruesit e ambienteve dhe pajisjeve të punës;
- Bashkitë, përveç Bashkisë së Tiranës;
- Organizuesit e eventeve;
- Arsimi parauniversitar, i cili përfshin shkollat e mesme dhe shkollat profesionale publike dhe private.

7. *Shtrirja territoriale*: Projekti do të zbatohet në territorin e Republikës së Shqipërisë.

8. *Forma dhe vlera e ndihmës*: Vlera e ndihmës shtetërore për vitin 2022 është 300.000.000 (treqind milionë) lekë në formën e grantit të drejtpërdrejtë nga fondet e miratuara për ministrin përgjegjës për sipërmarrjen. Çdo përfitues do të mbështetet në shumën 1.500.000 (një milion e pesëqind mijë) lekë për *startup*-et në fazën fillestare, 3.000.000 (tre milionë) lekë për *startup*-et në fazën e rritjes, 5.000.000 (pesë milionë) lekë për *startup*-et në fazën e zgjerimit, 10.000.000 (dhjetë milionë) lekë për lehtësuesit si: akademia, inkubatorët dhe përsheptuesit, hapësirat e punës, organizuesit e eventeve, arsimi parauniversitar; si dhe 20.000.000 (njëzet milionë) lekë për lehtësuesit Bashki.

III. Vlerësimi i ekzistencës së ndihmës shtetërore

9. Komisioni i Ndihmës Shtetërore vlerëson nëse plani i ndihmës shtetërore përbën ndihmë shtetërore në kuptim të nenit 4, pika 1, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, pra nëse plani ofron një avantazh ekonomik për ndërmarrje, e cila ka një ndikim të mundshëm në konkurrencë dhe tregtinë midis shteteve anëtare, që nuk do të ishte përfituar në kushte normale të tregut.

10. Neni 4, pika 1, e ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar, përcakton se:

“Përveç rasteve të parashikuara ndryshe në këtë ligj, ndalohet çdo ndihmë e dhënë nga burimet shtetërore, në çfarëdolloj forme e cila, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, shtrembëron ose kërcënon të shtrembërojë konkurrencën duke dhënë përparësi për një ose disa ndërmarrje të caktuara, ose për prodhimin e produkteve të caktuara, për aq sa mund të ketë ndikim në plotësimin e



detyrimeve të ndërmarrë nga Republika e Shqipërisë në marrëveshjet ndërkombëtare që përmbajnë dispozita të ndihmës shtetërore¹.

11. Gjithashtu, neni 71 “Konkurrenca dhe dispozita të tjera ekonomike”, i “Marrëveshjes së stabilizim-asociimit ndërmjet komuniteteve evropiane e shteteve të tyre anëtare dhe Republikës së Shqipërisë¹” përcakton se:

“Praktikat në kundërshtim me këtë nen vlerësohen në bazë të kriterëve që lindin nga zbatimi i rregullave të konkurrencës të aplikueshme në Komunitet, sidomos në nenet 81, 82, 86 dhe 87, të traktatit themelues të Komunitetit Evropian dhe instrumenteve interpretuese që përdoren nga institucionet e Komunitetit.”.

12. Ligji i ndihmës shtetërore zbatohet vetëm për masat që plotësojnë të gjitha kriteret e përmendura në nenin 4, pika 1, konkretisht: a) burime shtetërore; b) avantazhi ekonomik; c) selektiviteti; dhe d) efekti në konkurrencë dhe treg.

13. Ministri përgjegjës për sipërmarrjen ka njoftuar planin e ndihmës shtetërore, i cili lidhet me aktivizimin e burimeve shtetërore në formën e grantit, për mbështetjen e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme. Planin e ndihmës i jep një avantazh përfituesve, të cilët ata nuk do të ofrohej në kushtet normale të tregut. Avantazhi që ofrohet nëpërmjet planit të ndihmës është selektiv, pasi do të ofrohet vetëm për ndërmarrje të caktuara, përkatësisht ndërmarrje *startup* (paragrafi 6/a) dhe ndërmarrjet lehtësuese të *startup*-eve (paragrafi 6/b). Planin e ndihmës mund të shtrembërojë konkurrencën, pasi nëpërmjet tij forcohet pozicioni konkurrues i përfituesve nga skema. Planin e ndihmës gjithashtu ndikon në tregtinë ndërkombëtare, duke qenë se ndërmarrjet përfituese janë aktive në sektorë në të cilët ekziston tregtia rajonale.

Në këto kushte, Komisioni vlerëson se planin e njoftuar është ndihmë shtetërore.

IV. Vlerësimi i përputhshmërisë së skemës

14. Komisioni i Ndhmës Shtetërore vlerëson skemën e njoftuar në bazë të nenit 13, të ligjit nr. 9374/2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, ku parashikohet se ndihma shtetërore mund të lejohet nëse: “lehtëson zhvillimin e veprimtarive të caktuara ekonomike ose zhvillimin e zonave të caktuara

ekonomike, deri në atë masë sa kjo ndihmë nuk është në kundërshtim me detyrimet e marrëveshjeve ndërkombëtare, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë”. Komisioni vlerëson se rezultatet e planit të ndihmës pritet të jenë pozitive, duke qenë se skema ka efekt nxitës (përfituesi do të aplikojë për ndihmën shtetërore pranë dhënësit të ndihmës shtetërore, para fillimit të punimeve/projektit/ aktivitetit), zbatimi i saj është i domosdoshëm dhe se shkalla e mbështetjes është proporcionale me shpenzimet e pranueshme që mbulohen nga skema.

Sa më lart, Komisioni vlerëson se planin e ndihmës shtetërore është i lejueshëm në përputhje me nenin 4, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, në bazë të nenit 4, 17, 22, dhe 31, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë skemën e ndihmës shtetërore në formën e grantit për mbështetjen e *startup*-ve dhe lehtësuesit e *startup*-eve, të parashikuar në projektvendimin e KM-së “Për përcaktimin e kërkesave dhe kriterëve që duhet të plotësojnë *startup*-et dhe lehtësuesit e *startup*-eve, si dhe miratimin e procedurave dhe afateve të thirrjes për përfitimin e granteve dhe masave mbështetëse”.

2. Ministri përgjegjës për sipërmarrjen, brenda datës 31 mars të çdo viti, të paraqesë raport për impaktin e ndihmës shtetërore gjatë vitit paraardhës financiar. Raportet e zbatimit duhet të përmbajnë informacion të detajuar mbi shpenzimet e bëra dhe produktet e arritura.

3. Ministri përgjegjës për sipërmarrjen të njoftojë çdo ndryshim të planit të ndihmës.

4. Ministri përgjegjës për sipërmarrjen të ruajë deri në dhjetë vjet të gjitha të dhënat për zbatimin e skemës, pasi ndihma e fundit individuale të jetë dhënë në kuadër të kësaj skeme.

5. Ky vendim të botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Delina Ibrahimaj

¹ Ligji nr. 9590, datë 27.7.2006, “Për ratifikimin e Marrëveshjes së stabilizim-asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe komuniteteve evropiane e shteteve të tyre anëtare”.



VENDIM
Nr. 106, datë 24.5.2022

AUTORIZIM I NDIHMËS
SHTETËRORE “PËR AEROPORTIN
NDËRKOMBËTAR TË VLORËS”

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, me pjesëmarrjen e:

- Znj. Delina Ibrahimaj kryetare;
- Znj. Mimoza Dhëmbi anëtare;
- Znj. Etleva Haka anëtare;
- Znj. Mirjana Zisi anëtare;
- Z. Ahmet Maçellari anëtar.

Në mbledhjen e tij të radhës të datës 24.5.2022, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në bazë të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 817, datë 28.12.2005, “Për miratimin e rregullores ‘Për procedurat dhe formën e njoftimit’”, mori në shqyrtim njoftimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë të planit të ndihmës shtetërore të kontratës së koncesionit/partneritetit publik privat, për dhënien me koncesion/PPP për projektimin, ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e Aeroportit Ndërkombëtar të Vlorës (VIA), të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 325, datë 2.6.2021, “Për miratimin e kontratës së koncesionit/partneritetit publik privat, për dhënien me koncesion/PPP për projektimin, ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e Aeroportit Ndërkombëtar të Vlorës (VIA)”.

I. Procedura

1. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, me shkresën nr. 1851, datë 23.2.2022, në bazë të nenit 20, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, njoftoi në Komisionin e Ndihmës Shtetërore planin e ndihmës shtetërore të sipërpërmendur, në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 325, datë 2.6.2021, “Për miratimin e kontratës së koncesionit/partneritetit publik privat, për dhënien me koncesion/PPP për projektimin, ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e Aeroportit Ndërkombëtar të Vlorës (VIA)”. Ministria e Financave dhe Ekonomisë, me shkresën nr. 4480, datë 8.3.2022, i kërkoi dhënësit të ndihmës plotësimin e informacionit shtesë në njoftimin e planit të ndihmës shtetërore, të cilat u

dërguan nga ana e MIE-s me shkresën nr. 1851/2, datë 16.5.2022.

II. Përshkrimi i masës

2. *Objektivi*: Plani i ndihmës ka si objektiv kryesor zhvillimin dhe ndërtimin e infrastrukturës së re aeroportuale në rajonin e Vlorës dhe krijimin e kushteve të përshtatshme për një treg më konkurrues me shërbime ajrore të liberalizuara që do të sjellin mundësinë e një reduktimi në shpenzimet e udhëtimit për pasagjerët.

3. *Baza ligjore*: skema e ndihmës bazohet në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 325, datë 2.6.2021, “Për miratimin e kontratës së koncesionit/partneritetit publik privat, për dhënien me koncesion/PPP për projektimin, ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e Aeroportit Ndërkombëtar të Vlorës (VIA)”.

4. *Kohëzgjatja*: Plani i ndihmës do të zbatohet në 10 vjetët e parë, duke nisur nga data e operimit, të parashikuar në VKM-në nr. 325, datë 2.6.2021, “Për miratimin e kontratës së koncesionit / partneritetit publik privat, për dhënien me koncesion/PPP për projektimin, ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e Aeroportit Ndërkombëtar të Vlorës (VIA)” (periudha janar 2025–janar 2035).

5. *Dhënësi i ndihmës* dhe autoriteti përgjegjës për zbatimin e masës është ministri përgjegjës për transportin.

6. *Përfutuesi*: përfituesi i ndihmës shtetërore është bashkimi i operatorëve ekonomikë “Mabco Constructions” Sa, “Yda Insaat Sanayi Ve Ticaret Anonim Sirketi” dhe 2A Group sh.p.k. në cilësinë e Koncesionarit, që në kuptim të legjislacionit do të krijojnë shoqëri për qëllime të veçanta (SPV), krijuar posaçërisht për zbatimin e kontratës së koncesionit/PPP në fjalë. Shoqëria tashmë është krijuar me emrin: “Vlora International Airport – VIA sh.p.k.”.

7. *Shtrirja territoriale*: Projekti do të zbatohet në territorin e Republikës së Shqipërisë.

8. *Forma dhe vlera e ndihmës*: bazuar në pikën 11 (11.3, shkronja “b”) të kontratës “Detyrimet e Autoritetit Kontraktues” është parashikuar se në një periudhë prej 10 vjetësh, duke filluar nga data e operimit (“Periudha e garancisë”), Autoriteti Kontraktues do të garantojë Koncesionarin si më poshtë:

“Në rastin kur të ardhurat bruto vjetore janë më pak se të ardhurat minimale, Autoriteti Kontraktues do t’i paguajë



Koncesionarit diferencën midis të ardhurave bruto vjetore të llogaritura nga vlerësuesi sipas nenit 11.3 dhe të ardhurave minimale (“**Garancia e të ardhurave**”).

Sipas njoftimit, efektet financiare në buxhetin e shtetit nuk mund të jenë të matshme, sepse do të jenë në varësi të të ardhurave që do të ketë Koncesionari. Pra, në varësi të ecurisë së veprimtarisë ekonomike të subjektit, plani i ndihmës mund të aktivizojë burime shtetërore.

III. Vlerësimi i ekzistencës së ndihmës shtetërore

9. Komisioni i Ndhmës Shtetërore vlerëson nëse plani i ndihmës shtetërore, përbën ndihmë shtetërore në kuptim të pikës 1, të nenit 4, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, pra nëse plani ofron një avantazh ekonomik për ndërmarrje, e cila ka një ndikim të mundshëm në konkurrencë dhe tregtinë midis shteteve anëtare, që nuk do të ishte përfituar në kushte normale të tregut.

10. Neni 4, pika 1, e ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar, përcakton se:

“Përveç rasteve të parashikuara ndryshe në këtë ligj, ndalohet çdo ndihmë e dhënë nga burimet shtetërore, në çfarëdolloj forme, e cila, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, shtrembëron ose kërcënon të shtrembërojë konkurrencën duke dhënë përparësi për një ose disa ndërmarrje të caktuara ose për prodhimin e produkteve të caktuara, për aq sa mund të ketë ndikim në plotësimin e detyrimeve të ndërmarrja nga Republika e Shqipërisë në marrëveshjet ndërkombëtare që përmbajnë dispozita të ndihmës shtetërore”.

11. Gjithashtu, neni 71 “Konkurrenca dhe dispozita të tjera ekonomike”, i Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit ndërmjet Komuniteteve Evropiane e Shteteve të tyre Anëtare dhe Republikës së Shqipërisë², përcakton se:

“Praktikat në kundërshtim me këtë nen vlerësohen në bazë të kriterëve që lindin nga zbatimi i rregullave të konkurrencës të aplikueshme në Komunitet, sidomos në nenet 81, 82, 86 dhe 87 të Traktatit themelues të Komunitetit Evropian dhe instrumenteve interpretuese që përdoren nga institucionet e Komunitetit.”.

12. Legjislacioni për ndihmën shtetërore zbatohet vetëm për masat që plotësojnë të gjitha

kriteret e përmendura në nenin 4, pika 1, konkretisht: a) burime shtetërore; b) avantazhi ekonomik dhe selektiviteti; dhe c) efekti në konkurrencë dhe tregti.

- *Burime shtetërore*: duke qenë se ndihma e njoftuar parashikon mundësinë e financimit nga buxheti i shtetit, skema përfshin përdorimin e burimeve shtetërore.

- *Avantazhi ekonomik dhe selektiviteti*: skema e njoftuar parashikon mundësinë e dhënies së mbështetjes në formën e grantit nga burimet shtetërore të alokuara për Aeroportin Ndërkombëtar të Vlorës. Aktivizimi i këtij granti të mundshëm do të mundësojë dhënien e një avantazhi konkurrues përfituesit të skemës, kundrejt operatorëve të tjerë në të njëjtën treg të liberalizuar, duke reduktuar kostot që do të duhet të përballohen normalisht nga përfituesi për zhvillimin e aktivitetit ekonomik. Duke qenë se financimi i mundshëm publik jepet vetëm për funksionimin e aeroportit, skema është selektive.

- *Efekti në konkurrencë dhe tregti*: nëse burimet shtetërore (ndihma) e parashikuara në këtë skemë do të aktivizohet, atëherë përfituesi i saj do të konkurrojë me sipërmarrje të tjera në tregje të hapura. Skema ka efekt në tregti, pasi nëse ndihma do të jepet, atëherë përfituesi i skemës do të operojë në një treg, në të cilin shërbimet aeroportuale janë të liberalizuara, në të cilin shumë ndërmarrje nga shtetet e tjera konkurrojnë në treg.

Në këto kushte, Komisioni vlerëson se plani i njoftuar është ndihmë shtetërore.

IV. Vlerësimi i përputhshmërisë së skemës

13. Komisioni i Ndhmës Shtetërore vlerëson skemën e njoftuar në bazë të shkronjës “c”, të nenit 13, të ligjit nr. 9374/2005, “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar, ku parashikohet se ndihma shtetërore mund të lejohet, nëse: “*lehtëson zhvillimin e veprimtarive të caktuara ekonomike ose zhvillimin e zonave të caktuara ekonomike, deri në atë masë sa kjo ndihmë nuk është në kundërshtim me detyrimet e marrëveshjeve ndërkombëtare, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë*”. Sipas udhëzimit të Komisionit Evropian për ndihmën shtetërore për aeroportet dhe kompanitë ajrore³, ndihma operacionale për aeroportet sipas një skeme ndihme do të lejohet

² Ligji nr. 9590, datë 27.7.2006, “Për ratifikimin e Marrëveshjes së stabilizim-asocimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe komuniteteve evropiane e shteteve të tyre anëtare”.

³ https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/LSU/?uri=uriserv:OJ.C_.2014.099.01.0003.0.1.ENG



për një periudhë kohore prej 10 vjetësh, me kusht që të plotësohen gjashtë kushte në mënyrë kumulative, të parashikuara në pikën 79, të udhëzimit.

Kontributi për një përmbushur një objektiv të mirëpërcaktuar me interes të përbashkët: udhëzimi lejon që “ndihma operacionale do të konsiderohet se përmbush arritjen e një objektivi me interes të përbashkët për një periudhë kalimtare prej 10 vjetësh, nëse:

a) rrit lëvizshmërinë e qytetarëve të Bashkimit Evropian dhe lidhjen e tyre me rajonet duke vendosur pika aksesit për fluturimet brenda tregut të përbashkët;

b) eliminon bllokimin e trafikut ajror në aeroportet kryesore të tregut të përbashkët;

c) lehtëson zhvillimin rajonal.

Vendndodhja e aeroportit të ri në pjesën jugore të Shqipërisë shtrihet pranë fshatit Akerni, Novoselë, në Vlorë. Zhvillimi i Aeroportit Ndërkombëtar të Vlorës pritet që të përmirësojë lëvizjen e banorëve të Vlorës dhe më gjerë në rajon, duke e bërë udhëtimin ajror ekonomikisht më të përballueshëm dhe më të lehtë për t'u përdorur nga pasagjerët. Funksionimi i Aeroporti Ndërkombëtar të Vlorës do të shërbejë si një katalizator për të tërhequr vizitorë dhe turistë, si edhe zhvillimin e shërbimeve të nevojshme mbështetëse. Aeroporti Ndërkombëtar i Vlorës është planifikuar që të jetë një katalizator për zhvillimin ekonomik të rajonit të Vlorës. Për këto arsye, skema kontribuon në realizimin e një objektivi të përbashkët të mirëpërcaktuar interesi.

Nevoja për ndërhyrje shtetërore: udhëzimi parashikon se nevoja për financim publik për financimin e kostove operacionale, për shkak të kostove të larta fikse, varjon sipas madhësisë së një aeroporti dhe do të jetë proporcionalisht më i madh për aeroportet më të vogla. Sipas udhëzimit, në mënyrë që përfituesi i ndihmës të jetë i kualifikueshëm për ndihmë operacionale, duhet që trafiku vjetor i aeroportit të mos kalojë numrin 3 milionë të pasagjerëve. Sipas njoftimit, numri i pasagjerëve do të arrijë në 2,051,650 deri në vitin 2055, ku aeroporti i Ndërkombëtar i Vlorës do të arrijë kapacitetin e plotë. Për këto arsye, skema e njoftuar plotëson kriterin mbi nevojën për ndërhyrjen e shtetit.

Përshtatshmëria e ndihmës shtetërore si instrument i politikave: sipas udhëzimit parashikohet, se: “Një

masë ndihme nuk do të konsiderohet e pajtueshme me tregun e përbashkët, nëse ekzistojnë instrumente të tjera politikash të ndihmës më pak deformuese”. Sipas njoftimit, vlerësohet si instrumenti i përshtatshëm i parashikuar në formën e garancisë së të ardhurave është (shtojca nr. 3 e kontratës së koncesionit/PPP) instrumenti më i përshtatshëm.

Efekti nxitës: udhëzimi përcaktojnë se ndihma operacionale ka efekt nxitës nëse ekziston mundësia që, në mungesë të saj, niveli i aktivitetit ekonomik të aeroportit do të reduktohej ndjeshëm. Dhënësi i ndihmës, referuar studimit të fizibilitetit, argumenton se në mungesë të ndihmës operacionale, niveli i aktivitetit ekonomik do të impaktohej ndjeshëm (për shkak të konkurrencës, mundësia e rishikimit të tarifave të avionëve ose pasagjerëve gjatë periudhës së operimit etj.). Për këto arsye, ndihma e njoftuar do të ketë një efekt nxitës dhe, për këtë arsye, skema e plotëson këtë kusht.

Proporcionaliteti i madhësisë së ndihmës: sipas udhëzimit, kërkohet që plani i biznesit të aeroportit duhet të hapë rrugën për mbulimin e kostove operative, në fund të periudhës kalimtare. Sipas njoftimit, konsorciumi ndërkombëtar bazuar në përvojën e tij vlerëson një vlerë totale të investimeve në shumën 104 milionë euro. Planin e biznesit të aeroportit, parashikon që deri në vitin 2050 do të përmbushë vlerën e të investimit.

Shmangia e efekteve të panevojshme negative në konkurrencë dhe tregti: sipas udhëzimit, kur një aeroport ndodhet në të njëjtën zonë me një aeroport tjetër me kapacitet rezervë, plani i biznesit, i bazuar te numri i pasagjerëve dhe trafikut të mallrave, duhet të identifikojë efektin e mundshëm në trafikun e aeroporteve të tjera të vendosura në atë zonë. Sipas njoftimit, për shkak të konkurrencës, përfituesi i ndihmës nuk do të jetë në gjendje të rrisë mjaftueshëm tarifën e avionëve ose pasagjerëve gjatë periudhës së operimit. Për këtë arsye, skema e njoftuar është në përputhje me dispozitat e udhëzimit për parandalimin e efekteve negative të padëshiruara në konkurrencë dhe tregti.

Sa më lart, Komisioni vlerëson se plani i ndihmës shtetërore është i lejueshëm në përputhje me nenin 4 dhe shkronjën “c”, të nenit 13, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar.



PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, në bazë të neneve 4, 17, 22 dhe 31, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë skemën e ndihmës shtetërore të parashikuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 325, datë 2.6.2021, “Për miratimin e kontratës së koncesionit/partneritetit publik privat, për dhënien me koncesion/PPP për projektimin, ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e Aeroportit Ndërkombëtar të Vlorës (VIA)”.

2. Ministri përgjegjës për transportin, brenda datës 31 mars të çdo viti të paraqesë raport për impaktin e ndihmës shtetërore gjatë vitit paraardhës financiar. Raportet e zbatimit duhet të përmbajnë informacion të detajuar mbi shpenzimet e bëra dhe produktet e arritura.

3. Ministri përgjegjës për transportin të njoftojë çdo ndryshim të planit të ndihmës.

4. Ministri përgjegjës për transportin të ruajë deri në dhjetë vjet të gjitha të dhënat për zbatimin e skemës, pasi ndihma e fundit individuale të jetë dhënë në kuadër të kësaj skeme.

5. Ky vendim të botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Delina Ibrahimaj

KËRKESË

Nr. 87/9, datë 15.6.2022

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, të cilat preken nga disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 354, datë 16.6.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit ‘Për projektim, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e rrugës ‘Porti i Jahteve’ – Bypass Orikum–Dukat (Ura e Shën Elizës)’”.

Subjekti kërkuar i këtij projekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, bazuar në VKM nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, sipas tabelës paraprake bashkëlidhur.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 18,096,270.50 (tetëmbëdhjetë milionë e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind e shtatëdhjetë pikë pesëdhjetë) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
KRYETAR I KOMISIONIT
TË POSAÇËM TË SHPRONËSIMEVE
Erlis Hereni



Nr.	PRONARI			TË DHËNAT (mbi pasurinë sipas ZVRPP-së)				VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM SIPAS LLOJIT Ë PASURISË													VLERA TOTALE (lekë)	SHËNIME					
	Emri	Adësia	Mbiemri	ZK	Nr. Pas.	Lloji Pas.	Sip. Totale (m²)	Shpronësim tokë "aer"			Shpronësim tokë "rrual"	Sip. (m²)	Çmimi (lekë/m2)	Vlera (lekë)	Shpronësim tokë "pyll"			Ndërtesë banimi (shëpi)					Ndërtesë jo banimi		Ndërtesë ë total Sip.Nd. konf.ng a ZVRPP (m2)		
								Sip. (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)					Sip. (m2)	Çmimi (lekë/m2)	Vlera (lekë)	Sip.Ndërt konf. ZVRPP (m2)	Çmimi mes. sh/bletjeve sipas ZVRPP (l/m2)	Vlera (lekë)			Sip.Nd. konf.ng a ZVRPP (m2)	Vlera sipas Preventivi t (lekë)			
1	SHITET			1569	316/8	ARË	20355	1332	204	271,728.00															271,728.00	Konfirmuar ASHK Vlorë	
2	ESAT	ISUF	FISTI	1569	213/1	ARË	2100	586	204	119,544.00																119,544.00	Konfirmuar ASHK Vlorë
3	SERRI		JAZOJ	1569	194/13	ARË	13600	1623	204	331,092.00																331,092.00	Konfirmuar ASHK Vlorë
4	SHITET			1569	212/1	SHESH	13700	5169	0	0.00																0.00	Konfirmuar ASHK Vlorë
5	SHITET			1569	186/1	PEMË	2500	305	0	0.00																0.00	Konfirmuar ASHK Vlorë
6	SHITET			1569	187	KULLOTË	2700	834	0	0.00																0.00	Konfirmuar ASHK Vlorë
7	BASHKËPRONËSI			1569	48/8	ARË	4500	1555	204	317,220.00																317,220.00	Konfirmuar ASHK Vlorë
8	VIRON		MERKO	1569	47/1	ARË	4800	557	204	113,628.00																113,628.00	Konfirmuar ASHK Vlorë
9	LAÇË		MERKO	1569	47/2	ARË	3920	1502	204	306,408.00																306,408.00	Konfirmuar ASHK Vlorë
10	ELMAZ		MERKO	1569	47/3	ARË	3600	1750	204	357,000.00																357,000.00	Konfirmuar ASHK Vlorë
11	SELIM		HAVARI	1569	47/4	ARË	8920	110	204	22,440.00																22,440.00	Konfirmuar ASHK Vlorë
12	DASHAMIR		MERKO	1569	49/1	ARË	7300	38	204	7,752.00																7,752.00	Konfirmuar ASHK Vlorë
13	PETRIT		HAVARI	1569	49/3	ARË	4400	579	204	118,116.00																118,116.00	Konfirmuar ASHK Vlorë
14	ALIKO		MEHILLI	1569	49/6	ARË	2200	742	204	151,368.00																151,368.00	Konfirmuar ASHK Vlorë
15	IZET		MEHILLI	1569	49/5	ARË	2200	822	204	167,688.00																167,688.00	Konfirmuar ASHK Vlorë
16	SHITET			1569	64/14	ARË	2800	1297	0	0.00																0.00	Konfirmuar ASHK Vlorë kjo pasuri është okupuar nga Petrit Haveri
17	NOVRUZ		HAVARI	1569	64/13	ARË	5400	2029	204	413,916.00																413,916.00	Konfirmuar ASHK Vlorë
18	SEFER		HAVARI	1569	64/12	ARË	6300	2149	204	438,396.00																438,396.00	Konfirmuar ASHK Vlorë
19	GJERGJ		ALUSHAJ	1569	64/9	ARË	5450	502	204	102,408.00																102,408.00	Konfirmuar ASHK Vlorë
20	LIRI		ALUSHI	1569	64/10	ARË	3650	469	204	95,676.00																95,676.00	Konfirmuar ASHK Vlorë
21	EJUP		ALUSHI	1569	65/1	ARË	4000	876	204	178,704.00																178,704.00	Konfirmuar ASHK Vlorë
22	NEBI		ALUSHI	1569	65/2	ARË	4800	919	204	187,476.00																187,476.00	Konfirmuar ASHK Vlorë
23	ISUF		ALUSHI	1569	65/3	ARË	3400	1164	204	237,456.00																237,456.00	Konfirmuar ASHK Vlorë
24	FASLLI		ALUSHI	1569	65/5	ARË	2600	523	204	106,692.00																106,692.00	Konfirmuar ASHK Vlorë
25	SHITET			1569	65/7	ARË	400	190	0	0.00																0.00	KJO PASURI ËSHITË OKUPUAR NGA HAKI ALUSHI
26	SHITET			1569	65/8	ARË	500	174	0	0.00																0.00	KJO PASURI ËSHITË OKUPUAR BGA SINO KOZHËLI
27	SHITET			1569	65/9	ARË	1000	381	0	0.00																0.00	KJO PASURI ËSHITË OKUPUAR NGA KRISTO KOZHËLI
28	JORGO		KAZHËLI	1569	65/10	ARË	1200	1073	204	218,892.00																218,892.00	Konfirmuar ASHK Vlorë
29	NEBI		ALUSHI	1569	63/3	TRUALL	250			0.00	50	2135	106750.00													106,750.00	Konfirmuar ASHK Vlorë
30	SHITET			1569	62/20	ARË	1300	85	0	0.00																0.00	KJO PASURI ËSHITË OKUPUAR NGA NAJO ALUSHI
31	LIRI		ALUSHI	1569	62/19	ARË	9840	86	204	17,544.00																17,544.00	Konfirmuar ASHK Vlorë
32	SHITET			1569	62/18	ARË	700	111	0	0.00																0.00	KJO PASURI ËSHITË OKUPUAR NGA PETRO KOZHËLI
33	JORGO		KAZHËLI	1569	62/17	ARË	14000	117	204	23,868.00																23,868.00	Konfirmuar ASHK Vlorë
34	SHITET			1569	62/22	KULLOTË	370	70	0	0.00																0.00	Konfirmuar ASHK Vlorë



35	SHITET			1569	103/1	PEMË	5300	622	0	0.00										0.00	Konfirmuar ASHK Vlorë
36	SHITET			1569	65/6	ARË	900	422	0	0.00										0.00	KJO PASURI ESHTE OKUPUAR NGA MAJO ALUSHI
37	SHITET			1569	104	ARË	2500	1265	0	0.00										0.00	Konfirmuar ASHK Vlorë
38	SHITET			1569	63/1	PEMË	3300	8	0	0.00										0.00	KJO PASURI ESHTE OKUPUAR NGA KASTRIOT ALUSHI
39	SABRI	SINAN	ÇAPO	1569	111/1	PEMË	2400	675	204	137,700.00										137,700.00	Konfirmuar ASHK Vlorë
40	SABRI		ÇAPOJ	1569	108/1	ARË	1100	247	204	50,388.00										50,388.00	Konfirmuar ASHK Vlorë
41	SHITET			1569	108/2	ARË	3200	569	204	116,076.00										116,076.00	Konfirmuar ASHK Vlorë
42	VESEL		JAZO	1569	112/1	ARË	1000	422	204	86,088.00										86,088.00	Konfirmuar ASHK Vlorë
43	SHITET			1569	112/2	ARË	2400	308	204	62,832.00										62,832.00	Konfirmuar ASHK Vlorë
44	LADI	ISUF	FISTI	1569	213/2	ARË	2100	162	204	33,048.00										33,048.00	Konfirmuar ASHK Vlorë
45	SHITET			1569	419/1	PEMË	2700	127	0	0.00										0.00	KJO PASURI ESHTE OKUPUAR NGA MERKO DULE
46	HASAN		ÇAPO	1569	72/6	ARË	2400	51	204	10,404.00										10,404.00	Konfirmuar ASHK Vlorë
47	QËNDRO		ÇAPO	1569	72/5	ARË	2800	169	204	34,476.00										34,476.00	Konfirmuar ASHK Vlorë
48	SABRI		ÇAPO	1569	72/1	ARË	2700	532	204	108,528.00										108,528.00	Konfirmuar ASHK Vlorë
49	TAJAR		JAZO	1569	72/3	ARË	1000	112	204	22,848.00										22,848.00	Konfirmuar ASHK Vlorë
50	NEURO	MEMISH A	JAZOJ	1569	72/8	ARË	1000	98	204	19,992.00										19,992.00	Konfirmuar ASHK Vlorë
51	KRISTO		KUTELAJ	1569	359/18	ARË	1700	76	204	15,504.00										15,504.00	Konfirmuar ASHK Vlorë
52	ARISTIDH		KUTELI	1569	359/19	ARË	1700	86	204	17,544.00										17,544.00	Konfirmuar ASHK Vlorë
53	STEFANO		KUTELI	1569	359/20	ARË	1700	92	204	18,768.00										18,768.00	Konfirmuar ASHK Vlorë
54	VALBONA		REZVANA J	1569	359/21	ARË	1700	97	204	19,788.00										19,788.00	Konfirmuar ASHK Vlorë
55	BEGO		ÇAPOJ	1569	359/22	ARË	1700	124	204	25,296.00										25,296.00	Konfirmuar ASHK Vlorë
56	LJRI		KUTELAJ	1569	359/23	ARË	1700	440	204	89,760.00										89,760.00	Konfirmuar ASHK Vlorë
57	SHITET			1569	359/13	ARË	1552	43	0	0.00										0.00	Konfirmuar ASHK Vlorë
58	ARISTIDH		KUTELI	1569	359/24	ARË	1100	154	204	31,416.00										31,416.00	Konfirmuar ASHK Vlorë
59	STEFANO		KUTELI	1569	359/25	ARË	1100	149	204	30,396.00										30,396.00	Konfirmuar ASHK Vlorë
60	GLIRI		JEMINAJ	1569	359/26	ARË	1100	150	204	30,600.00										30,600.00	Konfirmuar ASHK Vlorë
61	GURI		JEMINAJ	1569	359/27	ARË	1100	176	204	35,904.00										35,904.00	Konfirmuar ASHK Vlorë
62	VALBONA		REZVANA J	1569	359/28	ARË	1100	164	204	33,456.00										33,456.00	Konfirmuar ASHK Vlorë
63	FLORA		RUMANI	1569	359/29	ARË	1100	160	204	32,640.00										32,640.00	Konfirmuar ASHK Vlorë
64	ZENEL	HODO	JEMINAJ	1569	313/8	ARË	2000	47	204	9,588.00										9,588.00	Konfirmuar ASHK Vlorë
65	FATOSH		MEHILLI	1569	410/6	ARË	5760	342	204	69,768.00										69,768.00	Konfirmuar ASHK Vlorë
66	SHITET			1569	48/9	ARË	966	966	0	0.00										0.00	Konfirmuar ASHK Vlorë
67	ELMAZ		KAPO	3140	518/1	ARË	4375	2553	204	520,812.00										520,812.00	Konfirmuar ASHK Vlorë
68	ANASTAS		MERKURI	3140	518/4	ARË	2400	188	204	38,352.00										38,352.00	Konfirmuar ASHK Vlorë
69	BP ALUSHAJ,CELAJ, MUÇOJ			1569	64/16	ARË	3600	889	204	181,356.00										181,356.00	Konfirmuar ASHK Vlorë
70	ZYKE	NJAZI	ALUSHAJ	1569	64/15	ARË	5700	1003	204	204,612.00										204,612.00	Konfirmuar ASHK Vlorë
71	RIZA		KUTELI	1569	301/3	ARË	9100	520	204	106,080.00										106,080.00	Konfirmuar ASHK Vlorë
72	SHYQYRI		HOXHA	1569	255/1	ARË	24500	1771	204	361,284.00										361,284.00	Konfirmuar ASHK Vlorë
73	SHYQYRI		HOXHA	1569	211/2	ARË	4700	1916	204	390,864.00										390,864.00	Konfirmuar ASHK Vlorë
74	ISUF		JAZOJ	1569	194/12	ARË	12350	1240	204	252,960.00										252,960.00	Konfirmuar ASHK Vlorë
75	ISUF		KUTELI	1569	309/3	ARË	16000	178	204	36,312.00										36,312.00	Konfirmuar ASHK Vlorë



76	SHTET			1569	192/3	ARË	51600	123		0.00										0.00	Konfirmuar ASHK Vlorë
77	BESIAN	FIRJAT	MEHILLAJ	1569	359/14	ARË	2000	238	204	48,552.00										48,552.00	Konfirmuar ASHK Vlorë
78	LORENC	HAMDI	JAZO	1569	359/16	ARË	1000	267	204	54,468.00										54,468.00	Konfirmuar ASHK Vlorë
79	SHTET			1569	359/13	ARË	1950	314		0.00										0.00	Konfirmuar ASHK Vlorë
80	Shtet			1569	188/1	PEMË	1050	195.5		0.00										0.00	Konfirmuar ASHK Vlorë
81	SINAN		FISTI	1569	211/1	ARË	2300	1132	204	230,928.00										230,928.00	Konfirmuar ASHK Vlorë
82	LAVDOSH		GLLAVA	1569	211/4	ARË	9360	1407	204	287,028.00										287,028.00	Konfirmuar ASHK Vlorë
83	MIHAL	THANAS	DHIMA	1569	280/15	ARË	5700	665.5	204	135,762.00										135,762.00	Konfirmuar ASHK Vlorë
84	QANI		MEHILLI	1569	283/1	ARË	17600	603	204	123,012.00										123,012.00	Konfirmuar ASHK Vlorë
85	Mehmet Vojçava Armida Armando Asent		Gega Gega Gega Gega Gega	1569	217/1	ARË	3280	103	204	21,012.00										21,012.00	Konfirmuar ASHK Vlorë
86	SHTET			1569	49/7	ARË	3560	369.3		0.00										0.00	Kjo pasuri është okupuar nga Qemal Mehili
87	SHTET			3140	519	ARË	88210	1420		0.00										0.00	Konfirmuar ASHK Vlorë
88	MUHARREM		JAZOJ	1569	192/4	ARË	2400	50.3	204	10,261.20										10,261.20	Konfirmuar ASHK Vlorë
89	TAJAR		KUTELAJ	1569	301/17	ARË	4130	188	204	38,352.00										38,352.00	Konfirmuar ASHK Vlorë
90	SHTET			1569	218/1	SHESH	8370	291		0.00										0.00	Konfirmuar ASHK Vlorë
91	FATOSH		MUCOJ	1569	274/1	ARË	16,980	705	204	143,820.00										143,820.00	Konfirmuar ASHK Vlorë
92	NIURO		BELLO	1569	256/1	ARË	22000	743	204	151,572.00										151,572.00	Konfirmuar ASHK Vlorë
93	BP JAZO			1569	194/11	ARË	22400	275	204	56,100.00										56,100.00	Konfirmuar ASHK Vlorë
94	SHTET			1569	219/14	ARË	26690	628		0.00										0.00	Konfirmuar ASHK Vlorë
95	SHTET			1569	49/11	ARË	1960	922		0.00										0.00	Konfirmuar ASHK Vlorë
96	SELIM		HAVARI	1569	49/10	ARË	1300	787	204	160,548.00										160,548.00	Konfirmuar ASHK Vlorë
97	PRENJO		HALILI	1568	211	ARË	2400	948	204	193,392.00										193,392.00	Konfirmuar ASHK Vlorë
98	PRENJO		HALILI	1568	215	ARË	1000	82	204	16,728.00										16,728.00	Konfirmuar ASHK Vlorë
99	PRENJO		HALILI	1568	214	ARË	700	20.3	204	4,141.20										4,141.20	Konfirmuar ASHK Vlorë
100	PRENJO		HALILI	1568	212	ARË	300	97.6	204	19,910.40										19,910.40	Konfirmuar ASHK Vlorë
101	SHTET			3621	634	KULLOTË	12500	934		0.00										0.00	për këtë pasuri nuk është lëshuar certifikatë pronësie
102	IMER	DERVISH	KOSHIN A	1569	280/14	TRUALI + NDËRTESË	250		204	0.00	121.8	21.35	260043		100		559199 4			5,852,037.00	
103	ASLLAN		SHAHAJ	2832	96/18	ARË	8500.0 8	1466. 5	204	299,166.00										299,166.00	-Kufizim i veprimeve të pronarit deri sa të provohet zgjidhja e mbivendosjes së konstatuar - haptëkohet në favor të emporiki bank k. hip nr. 1427/1206 dt. 24.4.2009 - ka 3 ndërtime pa leje ndër kufizimi -sekuestro konservative nr. 3817 prot dt. 17.5.2016 shërbëni përmbasimor " E.P.S.A"
104	ILIRJAN	OSMEN	ALICKAJ	1568	185/2	ARË	1000	668.6	204	136,394.40										136,394.40	çmimi i rivlerësimit 408000 lekë
105	ÇLIRIM	HYSNI	MUSARAJ	1568	185/1	ARË	2300	54	204	11,016.00										11,016.00	
106	AGIM		ALICKAJ	1568	184/1	ARË	1390	336.6	204	68,666.40										68,666.40	
107	AGIM		ALICKAJ	1568	193	ARË	700	558.5	204	113,934.00										113,934.00	
108	AGIM		ALICKAJ	1568	194	ARË	500	288.6	204	58,874.40										58,874.40	
109	ABIL		ABILI	1568	198/1	ARË	6330	1051	204	214,404.00										214,404.00	
110	MAMUDE	SHUAIP	ABILALIA J	1568	198/2	ARË	2050	452.4	204	92,289.60										92,289.60	



111	SHITET			1568	197/2	PEMETORE	2910	303		0.00												0.00	
112	SHITET			1568	197/4			2039.5		0.00												0.00	
113	DERVISI		ABILALLAJ	1568	198/3	ARË	3000	617.8	204	126,031.20												126,031.20	
114	NEZI	SHUAIP	NEZHAI	1568	356/1-ND2	NDËRTESE	94			0.00									94	1723079.5		1,723,079.50	kjo pasuri ngrihet mbi pasurinë nr. 356 zik 1568 mungon marrëdhënia me truallin
115	SHITET			1568	202/2	PEMETORE	2249	282.3	204	57,589.20												57,589.20	
	SHUMA									20,414,404.00												48,096,270.50	

**KËRKESË****Nr. 288/7, datë 13.6.2022****PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën për shpronësim, për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 144, datë 22.2.2017, të Këshillit të Ministrave “Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit ‘Rikualifikimi urban i qytetit të Pukës’”.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Bashkia Pukë.

Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personin e prekur nga ky shpronësim për interes publik për pasurinë e paluajtshme, pronë private, i cili do të kompensohet sipas vlerësimit paraprak të llogarit, si:

- Për objektin e llojit “njësi”, vlerësimi është bërë sipas VKM-së nr. 138, datë 23.3.2000, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së

masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar.

Personi që preket nga ky projekt i cili ka emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken por nuk figurojnë në këtë listë, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit në Bashkinë Pukë, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimin.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 1,528,477 (një milion e pesëqind e njëzetë e tetë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e shtatë) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
KRYETAR I KOMISIONIT TË POSAÇËM
TË SHPRONËSIMEVE
Erlis Hereni

LISTA EMËRORE PARAPRAKE E PRONARIT PASURIA E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, E TË CILIT PREKET NGA DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 144, DATË 22.2.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTT ‘RIKUALIFIKIMI URBAN I QYTETIT TË PUKËS’”

Lloji i pasurisë së paluajtshme që shpronësohet: “ndërtesë”.

Nr.	Të dhënat e pronës									
	Emri	Atësia	Mbiemri	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sip. totale e objektit të shpronësuar m²	Sip. që shpronësohet e objektit m²	Vlera e objektit me situacion lekë	Shënime
1	Gezim Mustaf Kurtalia			3069	1/422-N	Njësi	54.72	54.72	1,528,477	Konfirmuar nga ASHK, Drejtoria Vendore Pukë
Sipërfaqe totale shpronësimi m²								54.72		
Vlera totale paraprake e shpronësimit në lekë									1,528,477	

Shënime.

1. Për objektin e llojit “njësi”, vlerësimi është bërë sipas VKM-së nr. 138, datë 23.3.2000, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar.

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2022

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 64 lekë